



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:216914
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05716732

Pml.nr.261/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A. A., nga fshati ..., komuna e K., për shkak veprës penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 234, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, nr.2022:216914 të datës 06.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.695/2023 të datës 30.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit A. A., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.695/2023 të datës 30.01.2024, sa i përket veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe çështja penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin nr.2022:216914 të datës 06.10.2023 (pika I. e dispozitivit), të dënuarin A. A., e ka shpallur fajtor për shkak veprës penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 234, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje

prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.10.2022 deri më datën 17.07.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 17.07.2023 deri më datën 11.09.2023. Gjithashtu, ndaj të dënuarit A. A., është shqiptuar edhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) euro, të cilin dënim i dënuari është detyruar që të paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara me nenin 43, paragrafi 3 të KPRK-së, atëherë dënimi me gjobë do të ekzekutohet në atë mënyrë që i dënuari për çdo njëzetë (20) euro të papaguar, do ta mban nga një (1) ditë burgim.

Është detyruar i dënuari A. A., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë (pika II. e dispozitivit), i dënuari A. A., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale "Dhunimi", nga neni 227, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK-së dhe veprës penale "Shantazhi", nga neni 329, paragrafi 1 të KPRK-së.

E dëmtuara A. S., nga fshati ..., komuna e F., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës sa i përket këtyre dy veprave penale do të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.695/2023 e datës 30.01.2024 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket veprave penale për të cilat i dënuari A. A., është liruar nga akuza dhe sa i përket këtyre veprave penale, çështja penale është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjithashtu, me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit të Kosovës është aprovuar si e bazuar ankesa e të dëmtuarës A. S., ndërsa është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket dënimit të shqiptuar me burgim, ashtu ndaj të dënuarit A. A., për shkak të veprës penale "Mundësimi ose detyrimi në prostitucion", nga neni 234, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, kurse pjesa tjetër e aktgjykimit lidhur me dënimin me gjobë për këtë veprë penale ka mbetur e pandryshuar. Ndërsa, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit A. A., përkitazi me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Kundër këtyre aktgjykimeve, përkitazi me pjesën dënuese, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari A. A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulon aktgjykimet

e lartcekura, duke e kthyer çështjen në rigjykim apo këto aktgjykime të ndryshohen, duke e liruar të dënuarin nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.nr.146/2024 e datës 02.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit A. A.i, të aprovohet si e bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që mbrojtjes nuk i është dorëzuar një kopje e ankesës së të dëmtuarës A. S., në mënyrë që t'ju ipet mundësia e paraqitjes së përgjigjes në ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, përveç pretendimeve tjera, i dënuari A. A. thekson se mbrojtësit të të dënuarit, nuk i është dorëzuar një kopje e ankesës së të dëmtuarës A. S., andaj edhe në këtë mënyrë, i është mohuar e drejta ligjore për të dhënë përgjigje në ankesë, duke e pasur parasysh edhe faktin se paraqitja e kësaj ankese ka rezultuar me një epilog negativ për të dënuarin, pasi që të njëjtit i është ashpërsuar dënimi me burgim nga gjykata e shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i të dënuarit për mos dërgimin e ankesës së palës së dëmtuar është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është marrë pa informimin e të mbrojtjes lidhur me pretendimet e parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në dispozitën e nenit 388, paragrafi 3 të KPP-së, lidhur me procedurën për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda 8 (tetë) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafi 3 të këtij Kodi.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë, me rastin e pranimit të ankesës së palës së dëmtuar, nga një kopje të kësaj ankese nuk ja ka dërguar mbrojtjes, ndërsa seanca e kolegjit pranë gjykatës së shkallës së dytë, në të cilën janë shqyrtuar ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të shkallës së parë, është mbajtur pa ju dhënë mbrojtjes mundësia e paraqitjes së përgjigjes në ankesë, e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që ka për pasojë edhe anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë vetëm sa i përket pikave II. dhe III. të dispozitivit, që ndërliidhen me veprën penale për të cilën i dënuari A. A., është shpallur fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se njoftimi i mbrojtjes përkitazi me ankesat nënkupton mundësinë për tu informuar me përmbajtjen e tyre, përkatësisht me këtë mundësohet që i dënuari dhe mbrojtësi i tij të kenë mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe mundësinë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me ankesat. Andaj, edhe rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. të KPP-së lidhur me nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së, të cilat shkelje kanë ndikuar në të drejtat e të mbrojtjes të garantuara sipas dispozitave të KPP-së dhe të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 6 (“E drejta për një proces të rregullt”) të Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Nga arsyet e cekura më lartë del se aktgjykimi i shkallës së dytë (pikat II. dhe III. të dispozitivit) që ndërlidhet me veprën penale për të cilën i dënuari A. A., është shpallur fajtor është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat aktgjykimin në fjalë si të tillë e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm, për çka ka qenë nevoja që i njëjti të anulohet në këtë pjesë dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2. të KPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e rigjyimit duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e sipër cekura dhe pas evitimit të shkeljeve, të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve që dalin nga ankesat e paraqitura nga pala e dëmtuar dhe nga mbrojtësi i të dënuarit.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lartë dhe në kuptim të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.261/2024, më datë 15.05.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj